



**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Bekim Salihu dhe bashkëpunëtorin profesional Driton Ahmeti, në çështjen juridike, të paditësit [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED] nr. [REDACTED], të cilin me autorizim e përfaqëson [REDACTED] avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim [REDACTED] në çështjen për pagesë e pagave përcjellëse dhe jubilarë, në prezencën e paditësit dhe të autorizuarit të tij, si dhe të përfaqësuesit të të paditurës, në shqyrtimin e mbajtur me datë 06.12.2017, mori ndërsa me 21.12.2017, përpiloi këtë:

### AKT GJYKIM

**I. APROVOHET**, në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED] nr. [REDACTED]

**II. DETYROHET**, e paditura Komuna e Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, që paditëses në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi prej 1.390.68 €, dhe tri pagave jubilarë në lartësi prej 1.390.68 €, e që shuma e përgjithshme i bie **2781.36 € (dy mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një euro e gjashtëdhjetë e tetë cent)**, të cilën shumë e paditura është obliguar t'ia paguaj paditësit, së bashku me kamatën, e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponimet e rëndomta të qytetareve, të afatizuara për periudhë një vjeçare, pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 269.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

### Arsyetimi

Paditësi [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] përmes përfaqësuesit të tij, [REDACTED] avokat nga Ferizaj, me datë 29.03.2017, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, lidhur me pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe pagesën e tri pagave jubilarë.

*Pretendimet e palëve:*

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, me padi dhe parashtrimet në seancën e mbajtura ka deklaruar se qëndron pranë padisë dhe kërkesë padisë duke shtuar se konform nenit 52 të kontratës së përgjithshme kolektive ekziston detyrimi i të paditurës si punëdhënës se pas daljes në pension të paditësit t'ia paguaj tri paga në lartësi të mesatarës së pagave në tre muajt e fundit dhe pasi që paditësi të i njëjti punëdhënës i ka mbi 30 vite punë andaj ekziston detyrimi i të pagitures që për çdo 10 vite t'ia paguaj nga një pagë jubilarë që d.m.th. tri paga. Nuk qëndron pretendimi nga përgjigja në padi se pagesa e pagave jubilarë është parashkruar me theksimin se ka kaluar afati tre vjeçar i parashkrimit nga arsyeja se e drejta në kompenzimin e pagave jubilarë nuk rrjedhë pas kalimit të qdo 10 vjeçari, por ajo fitohet vetëm me rastin e pensionimit. Po ashtu është e pa bazuar edhe theksimi lidhur me mesataren e tre muajve të theksuar si më e ulët me atë të theksuar në padi nga arsye se në bazë të ekstraktit financiar të bashkangjitur si provë në padi vërtetohet qartë se sa ka qenë paga e paditësit në tre muajt e fundit para pensionit, andaj në bazë të kësaj i propozoj gjykatës që padinë e paditësit ta aprovoj si të themeltë duke e detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 3.120 € me kamatë sipas normës prej 8% duke filluar nga data 01.03.2017, e deri në pagesën definitive.

I autorizuari i të paditurës në përgjigjeje në padi të datës 23.06.2017 dhe në seancën e datës 06.12.2017, ka deklaruar se mbetet në tërësi si në përgjigjen në padi, duke kontestuar kërkesë padinë e paditësit lidhur me me të drejtën e realizimit të tri pagave jubilarë dhe tri paga përcjellëse, ngase në bazë të dispozitave të kontratës kolektive të lidhur në mesë MASHT dhe SBASHK-ut të datës 11.04.2014, është konstatuar se dispoziten normative të kësaj kontrate gjegjësisht neni 36 par 9 dhe 10, ku janë paraparë mënyra e realizimit të së drejtës së tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse, konstatojmë se në bazë të listave të pagave dhe shkresave zyrtare që janë në dosjen e lëndës shuma e kërkesës të paraqitur në kërkesëpadinë e paditësit nuk është ekuivalente me të paraqiturat që janë në listën e pagave dhe në shkresat e drejtorisë së arsimit. Sipas dispozitave ligjore të ligjit të punës, të ligjit të arsimit parauniversitar, drejtorja e arsimit nuk ka bërë ndonjë kontratë me ndonjë subjekt tjetër gjë që do ta obligonte për marrjen e obligimeve mbi çfarë do të drejte të punëtorëve arsimor pas daljes në pension dhe të gjitha provat e praqitura si dhe në bazë të theksimeve vijim deri te konkludimi juridik se padia dhe kërkesëpadia e paditësit nuk ka bazë ligjore.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes kontestimore, për aqë sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, gjykata ka administruar provat si vijojnë: *Kontrata për mësimdhënës e lidhur në mes Drejtorisë së Arsimit në Ferizaj, si dhe punëmarrësit [REDAKTUAR] me nr.protokolli 680/42 e datës 01.03.2015, dhe kontrata me nr. 75/3 e datës 03.09.2012, shkresa e Drejtorisë së Arsimit me nr.398 e datës 21.06.2017, përgjigja në kërkesën e Drejtorisë së Arsimit me nr.111 e datës 23.02.2017, në të cilat gjenden listat e pagave për muajin dhjetor 2016, janar dhe shkurt 2017, kontrata e punës për mësimdhënës me nr.72/3 e datës 01.09.2014, vendimi për ndërprerjen e marrëdhënjes së punës i Drejtorisë së Arsimit me nr.145 i datës 06.03.2017.*

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mesë palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension, e paditura nuk e ka kontestuar pretendimet në padi nga ana e paditësit se ka përvojën e punës mbi 30 vjet.

Me leximin e Kontratës së punës me nr. Protokolli:680/42 e datës 01.03.2015, Gjykata ka konstatuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie punë tek e paditura deri në momentin e pensionimit me datë 20.02.2017. Me leximin e Librezës së punës gjykata ka konstatuar se paditësi ka punuar tek e paditura nga data 25.09.1972, e deri në momentin e pensionimit me datë 20.02.2017, me leximin e Shkresës zyrtare nr.111 të datës 23.02.2017, gjykata ka konstatuar se paditësit ju është refuzuar kërkesa për kompensimin e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë, me leximin e shkresës zyrtare e me nr. protokolli: 398 e datës 21.06.2017, gjykata ka konstatuar se paditësi në tre muajt e fundit ka realizuar mesatare e pagës në shumë prej 1390.68 €.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë për tri paga jubilarë në shumën prej 1390.68€, si dhe tri pagave përcjellëse në shumën prej 1390.68 €, e ka marrë për bazë kontratën e punës të lidhur në mes paditëses dhe të paditurës të dt.01.03.2015, si dhe shkresave të paditurës me nr. protokollit nr.398 të datës.21.06.2017, ku vërtetohet se paditësi në muajt fundit para

daljes në pension dhe atë në dhjetor 2016, janar dhe shkurt 2017, është vërtetuar se mesatarja e pagave mujore e tij ka qenë 463.56€.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 53 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët ndërsa zbatohet prej 01 Janar të viti 2015, ndërsa me nenin 51 të kësaj kontrate zbatohet në rastin ku ka implikime financiare.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontratë për faktin se me rastin e daljes së tij në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurës.

Në nenin 36 par. 9 pika 9.1 dhe 9.23, të kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi, i fundit në vlerë të një page bazë, për 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy pagave bazë dhe për 30 vite të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave bazë, punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërblimin jubilar, te shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension paditësit brenda 1 muaji sipas nenit 36 par. 9 pika 9.5, të ia paguajë tri paga jubilarë pasi që i ka plotësuar këto kushte, pasi ka pasur përvojën e punës mbi 30 vjeçare dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkesë qoftë gojore apo me shkrim të paditurës.

Kurse neni 36 par. 10 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesat përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, e në rastin konkret gjykata ka marr parasysh që tri pagat e fundit të punëmarrësit kanë qenë 1390.68 € dhe nuk ka pas ndonjë ndryshim në tre muajt e fundit para daljes në pension dhe me rastin e vendosjes është bazuar në këtë fakt se meqenëse nuk ka pasur ndryshime në pagat që të merret

një mesatare e ka marr për bazë tri pagat e fundit që ka ndodh në rastin konkret rezulton se paditësi ka pasur pagën mujore tek e paditura shumë prej 463.56 €.

Pretendimet e përfaqësuesit të paditurës se paditësi kërkesën për kompensimin e pagave përcjellëse duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka pasur fonde të veçanta që ti përmbushë këto detyrime, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara, për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha DKA, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste dhe se nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësi.

Kurse sa i përket asaj që pagat jubilarë janë të parashkruara pasi që në nenin 36 par. 9 pika 9.5 kjo bëhet brenda një muaji për çdo 10 vite, ku paditësi ka bërë dhe në atë kohë është dashur të realizohen këto të drejta. Gjykata konsideron se një pretendim i tillë është i pa bazuar se në rastin konkret nuk kemi parashkrim, pasi që sipas nenit 36 par. 9, thuhet qartë se për të përfitur pagat jubilarë punëtorët e SBSHK-ut, në rastin konkret paditësi duhet që fillimisht të dali në pension që të përfitojnë shpërblimin jubilar e jo në kohën sa janë në marrëdhënie pune, respektivisht kur i kanë bërë 10 vite përvojë pune, 20 apo 30, siç parashihet me këtë nen 36 par. 9 pika 9.1, 9.2 dhe 9.3.

Se pretendimi i përfaqësuesit është i pa bazuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me institutin e parashkrimit pasi që kjo është rregulluar me dispozitat ligjore të ligjit të punës nr. Ligji 03/L-212 dhe çështja e parashkrimit është e rregulluar me nenin 87 dhe ky afat nuk mundet me u ndryshu me marrëveshje në mes të palëve, se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me zbatimin e institutit të parashkrimit është edhe për faktin se në nenin 36 par. 9 pika 9.4, thuhet decidivisht se punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpenzimin jubilar, e që në rastin konkret rezulton se paditësi ka dal në pension tek e paditura dhe kjo ka për obligim që të i paguajë paditësit një page jubilarë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, ka obliguar të paditurën që t'ia kompensoj shumë prej 279.00 €, për përpilim të padisë shumë prej 104.00 €, për një seanca të mbajtur shumë prej: 135.00 €, dhe taksën gjyqësore për padi në shumë prej 30.00 €.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.272/17 date 21.12.2017

Gjyqtari,  
Bekim Salihu



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC

